



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____ / 2020

**“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.01.1995 “KODI PENAL I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja “d”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Pas nenit 52/a shtohet neni 52 /b me kete përmbajtje:

“Neni 52/b

Perjashtimi nga denimi për krimet në fushën e zgjedhjeve

Personi që ka kryer nje ose me shume vepra penale të parashikuara në Kreun X të këtij Kodi i cili bashkëpunon dhe ndihmon organet e ndjekjes penale për hetimin, si dhe për zbulimin e personave te tjerë, bashkëpunëtorë në kryerjen e veprës penale ose autorë të veprave të tjera të lidhura, përjashtohet nga dënimi për veprën penale të kryer prej tij.”

Neni 2

Në nenin 328 shfuqizohen fjalët “në kundërshtim me ligjin”.

Neni 3

Në paragrafin e fundit të nenit 328/a, shfuqizohen fjalët “në kundërshtim me ligjin dhe qëllimin e detyrës,”.

Neni 4

Në nenin 328/b shfuqizohen fjalët “në kundërshtim me ligjin”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Gramoz RUÇI